

DHOMA ZGJEDHORE

REKOMANDIME

Nisur nga vëzhgimet e mësipërme, anëtarët e Dhomës Zgjedhore kanë këto rekomandime si më poshtë:

Së pari, rekomandojmë ndryshime në Kodin Zgjedhor për të siguruar që sistemi zgjedhor të krijojë **mundësi të barabarta në garim për** të gjithë subjektet zgjedhore, sidomos për kandidatët apo partitë që duan të garojnë jashtë koalicioneve të mëdha. Në këtë mënyrë sigurohet barazia e votës së qytetarëve, pavarësisht se për kë subjekt votojnë.

Së dyti, rekomandojmë që të ndërmerren hapat e nevojshëm që në zgjedhjet e ardhshme vendore, partitë të garojnë **me lista të hapura për Këshillin Bashkiak**. Në këtë mënyrë qytetarët do të kenë mundësi të njihen me përfaqësuesit e tyre, dhe anëtarët e Këshillit mund të përforcojnë marrëdhënien e tyre me komunitetin.

Së treti, rekomandojmë që të amendohet ligji zgjedhor për të bërë të detyrueshme që partitë politike, të depozitojnë në KQZ sëbashku me listat e kandidatëve të tyre për kryetar bashkie apo këshilla bashkiak, edhe **vendimet e organeve drejtuese të partisë politike**, sipas statutit të tyre të regjistruar në Gjykatë.

Së katërti, rekomandojmë marrjen e masave që në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të garantohet **votimi i Shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë**. Një hap i tillë do të do t'i jepte mundësinë këtyre qytetarëve, që ashtu siç prej dy dekadash kontribuojnë në ekonominë Shqiptare, të kontribuojnë edhe në jetën politike të vendit.

Së pesti, rekomandojmë që të rishikohet kuadri ligjor për të vendosur **kufizim në numrin e mandateve** që një kryetar bashkie mund të kandidojë. Në demokraci të pakonsoliduara kufizimi i numrit të mandateve, rrit mundësinë për qarkullimin e elitave dhe ul mundësitë për krijimin e monopoleve apo konsolidimin e tarave që veprojnë në kundërshtim me interesin publik.

Së gjashti, rekomandojmë marrjen e masave nga organi i prokurorisë për të luajtur një rol më aktiv në hetimin e veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Në veçanti veprat penale që lidhen **me blerjen e votës** përmes parave apo premtimeve për sigurimin e një vendi pune. I bëjmë thirrje qytetarëve që votën e tyre ta shohin si

një përgjegjësi qytetare dhe jo si një mall që shitet në treg. I bëjmë thirrje partive politike që të luajnë një rol më aktiv kundër këtij fenomeni, pasi në nivel afatgjatë ai mund të rezultojë tepër i dëmshëm edhe për vetë këto parti.

Së shtati, rekomandojmë që të merren sa më parë masat për plotësimin e kuadrit ligjor të nevojshëm që garanton **transparencë të plotë financiare** të fushatave zgjedhore, duke përmbushur kështu edhe detyrimet kushtetuese. Për më tepër i bëjmë thirrje Prokurorisë që të hetojë burimet e financimit të partive politike për shpenzime elektorale që janë dukshëm disa herë më të larta se të ardhurat e deklaruara prej tyre. Rekomandojmë gjithashtu që kandidatët garues në zgjedhjet vendore dhe parlamentare të detyrohet me ligj për të deklaruar pasurinë e tyre dhe për ta bërë atë publike përpara ditës së votimit.

Së teti, rekomandojmë që ligji për dekriminalizimin të përfshijë **ndalimin e personave me të shkuar kriminale** që të kandidojnë si në zgjedhjet vendore ashtu edhe ato parlamentare.

Së nënti, rekomandojmë që të merren masat që në zgjedhjet e ardhshme Shqipëria të shkojë drejt një **administratë zgjedhore profesioniste dhe jopartiake**, duke e shkëputur një herë e mirë procesin nga kontrolli dhe lojrat e partive politike.

Së dhjeti, rekomandojmë marrjen e masave sa më parë që në zgjedhjet e ardhshme të gjithë **personave me aftësi të kufizuar tu garantohet mundësia për të votuar**. Duke qenë se një pjesë e qendrave të votimit janë godina të shkollave publike, i bëjmë thirrje kryebashkiakëve të rinj që të kujdesen që sa më parë çdo shkollë të jetë e aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara.

Së njëmbëdhjeti, rekomandojmë **ndëshkimin** prej KQZ-së për partitë politike që shkelën ligjin zgjedhor duke filluar fushatën zgjedhore para afateve të parashikuara nga ligji, apo që thyen **heshtjen zgjedhore**.

Së dymbëdhjeti, rekomandojmë marrjen e masave për të shtuar **mbrojtjen ligjore për punonjësit e administratës publike**, në nivel qendror dhe lokal, me qëllim për të penguar përdorimin apo angazhimin e tyre në fushatë zgjedhore. Rekomandojmë një rol më aktiv të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave të punonjësve të administratës publike gjatë fushatës zgjedhore.

Së trembëdhjeti, rekomandojmë rikompozim të funksionit dhe kompetevave të Bordit Drejtues të Mediave audiovizive për të bërë atë më funksional, më të paanshëm dhe më efektiv në monitorimin e veprimtarisë së mediave gjatë periudhës zgjedhore.